




REPubLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
KUKËS



Nr.Rregj.Them (61014-00439-55-2017)116  
Data e rregj. 22.09.2017

Nr.Vendimi (1033) 116  
Data e vend. 16.10.2017

VENDIM

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës e përbërë nga:

Gjyqtare: Alma AHMETI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Esmeralda GECA, në Kukës, sot më datë 16.10.2017, mori në shqyrtim në séancë gjyqësore publike, çështjen penale me Nr.Rregj.Them 116 që i përket:

KËRKUES:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës, përfaqësuar në gjykim nga prokuror z.Edmond Kariqi.

IDYSHUAR:

Liman Morina, i biri i Alush-it dhe i Dritë-s, i datëlindjes 20.08.1969, lindur dhe banues ne Pogaj, Bashkia Kukes, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padenuar më parë, me arsim të lartë, i hetuar në gjendje të lirë, i mbrojtur me avokat të zgjedhur sipas prokurës së posaçme nr.3378 rep, nr.912 kol, datë 04.10.2017 nga av.Aurora Guska, me nr.licence 1989 dhe NIPT K37508235 R.

OBJEKTI:

Pushimin e çështjes penale nr.286, të vitit 2017, për veprën penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje", parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE:

Nenet 328/1/b dhe 329/a të Kodit të Proçedurës Penale.

KALLËZUES:

Muhamet Pavdeja, i biri i Isuf-it dhe i Hate-s, i datelindjes 05.03.1991, lindur dhe banues në fshatin



Gajrep banesë private pa numer, Bashkia Has, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, me arsim 8 klasë, me gjendje civile beqar.

Gjykata pasi zhvilloi hetimin gjyqësor të plotë e të gjithanshëm, administroi provat e paraqitura në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet përfundimtare të palëve të cilët përfundimisht kërkuan:

**Prokurori** kërkoi *pushimin e çështjes penale nr.286, të vitit 2017, për veprën penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje", parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, pasi personi nën hetim Liman Morina nuk provohet të ketë kryer veprën penale për të cilën është i dyshuar*".

**Av.Aurora Guska** kërkoi *pushimin e çështjes penale ndaj shtetasit Liman Morina për shkak se nuk provohet të ketë kryer veprën penale për të cilën është i dyshuar*".

**Kallëzuesi Muhamet Pavdeja** u shpreh *çështja le të pushohet por ato që kam thënë janë të vërteta,*

si dhe pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes,

### VËREN:

#### **I. Rrethanat e çështjes:**

1. Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr.286, të vitit 2017, për veprën penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje", parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, pasi personi nën hetim Liman Morina nuk provohet të ketë kryer veprën penale për të cilën është i dyshuar.

2. Gjykata verifikoi kryesisht *juridiksionin dhe kompetencën* për gjykimin e kësaj çështjeje penale dhe çmון se çështja objekt gjykimi është në juridiksionin penal të kësaj gjykate, sipas nenit 69 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka kompetencën lëndore dhe tokësore për gjykimin e kësaj çështjeje, sipas nenit 329/a të K.Pr.Penale. Në zbatim të nenit 13/2/c të K.Pr.Penale, kjo çështje penale u shqyrtua në trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar. Gjykata bazuar në nenin 329/a të K.Pr.Penale kërkesa për pushim iu njoftua dhe të pandehurit e mbrojtësit të tij si dhe personit që ka paraqitur kallzim penal.

3. Në datë 24.06.2017, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës, mbi bazën e kallzimit të shtetasit Muhamet Pavdeja, ka rregjistruar procedimin penal Nr.286/2017, për veprën penale të "Korrupsioni aktiv në zgjedhjes", parashikuar nga neni 328 i K.Penalk, duke rregjistruar dhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale Liman Morina.

4. Nga tërësia e akteve të fashikullit të procedimit penal nr.286 të vitit 2017, të administruar në gjykim rezulton se: Më datë 24.06.2017 shtetasi Muhamed Pavdeja bazuar

i fshatit Gajrep Bashkia Has, ka paraqitur kallzim penal. Në këtë kallzim sqaron se ka në përdorim numrin e telefonit 0686182674 dhe rreth orës 12 03 minuta e ka telefonuar shtetasi Flamur Cahani me numer celular 0694535500, i cili i ka thënë se prefekti Liman Morina kërkon numrin e babait të tij. Ai e ka pyetur se përse e kërkon prefekti numrin e celular të babait. Flamuri i është përgjigjur se po të dërgoj numrin e celularit të Prefektit për të fol vet me të dhe i ka dërguar me sms numrin celular 0662095107.

5. Shtetasi Muhamed Pavdeja në kallzim dhe në deklaratimet e dhëna sipas procesverbalit "Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale", i datës 24.06.2017 ka shpjeguar se i ka telefonuar Prefektit por nuk i është përgjigjur. Më pas e ka telefonuar vet Prefekti i cili i ka thënë se është Liman Morina dhe e priste tek lokali. Ai ka shkuar tek lokali që quhet "Pashtriku" për t'a pyetur se ç'farë ka. Kur ka hyrë në lokal e ka takuar në një tavolin të lokalit dhe ishte në shoqëri të shtetasit Ndriçim Neza. Në këtë kohë janë ngritur të dy nga tavolina, pasi e përcolli Limani deri tek dera e lokalit Ndriçimin, është kthyer Prefekti dhe i ka thënë se sa anëtarë bëhen në shtëpi që votojnë. Kallëzuesi i është përgjigjur se janë 6 anëtarë që votojnë. Në vijim në kallëzim ka shpjeguar se prefekti i ka ofruar lekë për të votuar nr.2 për Partinë Socialiste duke i thënë mbi frigorifer i ke ato, merri dhe ik. Kallëzuesi shpjegon se është futur në dhomë dhe ka parë se ishin 6 copë prerje të holla 5 mijë lekëshe gjithësej 30 mijë lekë, i ka marrë dhe ka dalë nga lokali. Ai gjatë deklaratimit ka shpjeguar se e ka inçizuar në audio në telefonin e tij shtetasin Liman Morina.

6. Gjithashtu ai ka deklaruar se pasi i ka futur lekët në xhep ka shkuar dhe ka takuar Kryetarin e Partisë Demokratike të Rrethit Has Miftar Dauti, të cilit i ka thënë se Prefekti i ka dhënë lekë dhe ai i ka thënë se duhet ta denoncosh.

7. Nga policia gjyqësore i janë sekuestruar në cilësinë e provës kallëzuesit 6 prerje 5 mijë lekëshe, një aparat celular Alcatel.

8. Nga policia gjyqësore është bërë kqyrja e celularit ku rezulton se i janë dërguar tre sms që i ka dërguar drejt numërit cel.0662095107 nga kallëzuesi, si dhe një sms nga numëri cel.0694535500 nga Flamur Cahani dërguar kallëzuesit, si dhe një inçizim audio që ndodhet në telefon një bised që zgjat 1 min e 7 sek.

9. I pyetur si person që tregon rrethanat e hetimit shtetasi Flamur Cahani ka deklaruar se gjatë përshendetjes që ka shkëmbyer me Prefektin në qytetin Krumë, ai i ka kërkuar numrin e celularit të shtetasit Isuf Pavdeja.

10. I pyetur si person nën hetim shtetasi Liman Morina, ka deklaruar se ushtron detyrën e Prefektit për Qarkun Kukës. Ai ka deklaruar se është një inskenim, pasi me datë 23.06.2017 kam kërkuar numrin e shtetasit Isuf Pavdja për të komunikuar me këtë shtetas në lidhje me një konflikt që ky shtetas ka me fisin me mbiemer Derri në të njëjtën lagje

ku dhe ky banon kishte dhe ka akoma konflikt. Djali i tij shtetasi Muhamed nuk e di si e ka marrë këtë informacion pra që unë kam kërkuar numrin e celularit të babait të tij shtetasit Muhamed dhe me ka dërguar një mesazh që dua të takoj. Ky mesazh më ka ardhur ne datë 23.06.2017 mesazh te cilin unë në këtë datë nuk e kam lexuar por e kam lexuar ate pasi një ditë ka dërguar përseri tjetër mesazh keshtu që janë dërguar dy mesazhe. Ai gjatë deklarimit ka shpjeguar se shtetasin Muhamet Pavdeja nuk e njeh fare dhe më datë 24.06.2017 afersisht rreth orës 16:00 ka shkuar në lokalin, me emër Pashtriku, pronë e vëllait të tij. Pasi është futur brenda ka parë një person të moshës rreth 20-30 vjeç. Ky djali i është përgjigjur se është djali i Isuf Pavdeja. Deklaruesi i ka thënë përse rrini natën nëpër rrugë duke bllokuar ato pasi pengoni qarkullimin pasi kështu kishte informacion që ndodhte ky fenomen. Shtetasi Muhamd Pavdeja i është përgjigjur që edhe dalim nganjeherë. Në vijim shpjegon se në lidhje me daljen ne media të një inçizimi në audio në të cilin aludohet në drejtimin e tij për një shprehje në një sekuenca "që e ke sipër te frigoriferi". Pikersht kjo shprehje është vertet që është përdorur nga ana e tij por është thënë në kuptim që kishte çelësat e makinës sipër frigoriferit te ndodhur brenda në lokal dhe i ka thënë kamarierit t'i jepte çelësat e makinës. Me këtë shtetas nuk ka biseduar asnjë bisedë për shitje apo blerje votash.

11. Nga shkresa me nr.LD/1140/MA datë 05.07.2017 e kompanisë telefonike Plus Communication sh.a si dhe traskiptimi i tabulateve telefonike rezulton që numri cel.0686182674, derguar sms drejt numërit cel.0662095107, si dhe thirrje me numër cel.0662095107 drejt numrit cel.0686182674, datë 24.06.2017, bashkelidhur me printuar dy fletë me tabulatet e thirrjeve, për të cilën personi nën hetim ka deklaruar fakt të till.

12. Gjithashtu në datë 11.09.2017 nga eksperti është bërë këqyja e sendeve gjasha kartemonedha të prerjes\*500 të sekuestruar në cilësin e provës materiale, ku nga ekspert kriminalist është konkluduar që kartëmonedhat janë këqyrë në kushtet laboratorike me mjete dhe teknik kriminalistike, u përpunuan me pluhur daktiloskopik dhe mbi sipërfaqen e tyre shihen gjurmë në formë njollash, por pa vija papilare, pra pa vlera identifikuese. Gjatë këqyrjes nuk u konstatua ndonjë gjurmë tjetër me vlera për hetimin.

13. Nga oficerët e policisë gjyqësore është bërë këqyrje e telefonit të sekuestruar shtetasit Muhamet Pavdeja Objekti i këqyrjes celulari i lartpërmendur, hapet tek audio është inçizim që zgjate 01 min e 07 sek datë 24.06.2017 audio pa filmim, të cilin u hap gjatë xhirimit dëgjohen zhurmë dhe biseda të pakuptushëm, zëra personash, zhurmë dhe gjatë sekuencës dëgjohet në të njëjtën kohë zëra personash dhe fjalë te frigoriferi dëgjohet zhurmë por nuk dëgjohen emra personash.

14. Prokurori pasi ka kryer të gjitha veprimet hetimore të mundshme ka arritur në konkluzionin se nuk provohet që personi nën hetim Liman Morina të ketë kryer veprime penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" parashikuar nga neni 328 i K.Penal, për...

ndjkeja penale ndaj personit nën hetim nuk duhet të vazhdojë dhe çështja në ngarkim të tij duhet të pushohet.

15. Me vendimin e datës 20.09.2017, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës ka vendosur pushimin e çështjes penale nr.286 të vitit 2017, për veprën penale të "Korrupsioni aktiv në zgjedhje", parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal. Këtë vendim pushimi e ka paraqitur për miratim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

## II. Legjislacioni i zbatueshëm:

16. Neni 328 i K.Pr.Penale, me titull "*Pushimi i akuzës ose çështjes*", përcakton: "*1.Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:*

a) *del qartë se fakti nuk ekziston;*

b) *fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;*

c) *viktima nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij;*

ç) *personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet;*

d) *ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;*

dh) *del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;*

e) *me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale;*

ë) *i pandehuri vdes;*

f) *në rastet e tjera të parashikuara me ligj.*"

17. Neni 329/a i K.Pr.Penale, me titull "*Kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes*", përcakton: "*1.Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të séances paraprake pushimin e akuzës ose çështjes.*

*2.Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq.*

*3. Kërkesës së prokurorit i bashkëlidhen aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimeve, duke përfshirë edhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprake, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër.*

*4.Kërkesa i njoftohet të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim. Ata kanë të drejtë të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre*"

18. Neni 329/b i K.Pr.Penale, me titull "*Shqyrtimi i kërkesës*", përcakton: "*1.Brenda pesë ditëve nga depozitimi i kërkesës, gjykata njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet*

e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, për datën dhe vendin e gjykimit.

2. Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në séance me dyer të mbyllura në prani të palëve. Kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj.

3. Kur janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, gjykata vendos pushimin e akuzës ose çështjes. Në rast të kundërt, gjykata vendos sipas parashikimeve të shkronjës "b" ose "c", të paragrafit 3, të nenit 329, të këtij Kodi.

4. Kur gjykata vendos sipas shkronjës "b", të paragrafit 3, të nenit 329, të këtij Kodi, cakton prokurorit një afat për kryerjen e hetimeve.

5. Kur është rasti, zbatohen rregullat e parashikuara nga paragrafi 4, i nenit 329, të këtij Kodi.

6. Kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake mund të bëhet ankim në gjykata të apelit. Zbatohen për atë që janë të pajtueshme rregullat e përcaktuara në nenin 329 të këtij Kodi".

### III. Arsyetimi i gjykatës.

19. Gjykata pasi çmoi në tërësi provat, në analizë të pretendimeve të paraqitura dhe në raport me dispozitat procedurale penale që lidhen me kontrollin gjyqësor të veprimtarinë e prokurorit në fazën e hetimeve çmon se kërkesa e prokurorit për pushimin e çështjes penale nr.286/2017 është e bazuar në ligj dhe në prova.

20. Në Kodin e Procedurës Penale, nenin 329/a të tij, është parashikuar kompetenca e gjyqtarit të seancës paraprake për të vendosur pushimin e çështjes kur procedimi është rregjistruar për krime si dhe kur ekziston një nga rastet e nenit 328/1. Në konkret prokurori e bazon kërkesën për pushimin e çështjes në nenin 328/1/a të kësaj ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë, për shkak se nuk provohet se personi nën hetim ketë kryer veprën penale për të cilën është i dyshuar .

21. Gjykata çmon se kërkesa e prokurorit është e bazuar në ligj dhe në prova. Në konkret janë kryer të gjitha veprimet hetimore të mundshme dhe të nevojshme në procedimin penal nr.286/2017, të rregjistruar për personin e dyshuar Liman Morina.

22. Nga policia gjyqësore janë pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale të gjithë personat që mund të kenë dijeni për rrethanat e çështjes, për veprën penale të cilën është paraqitur kallëzim.

23. Nga kallëzuesi është pretenduar se i është dhënë nga personi nën hetim një listë parash për të votuar në zgjedhjet e përgjithshme të datës 25.06.2017, në favor të partisë politik të caktuar. Kjo shumë të hollash është sekuestruar. Në datë 11.09.2017 ekspert i kriminalist është bërë këqyrja e sendeve gjashtë copë kartëmonedha të 500 Lekë të sekuestruara në cilësinë e provës materiale, ku kartëmonedhat janë të...

orën e  
byllura,  
refuzon  
aj.  
shimin  
ronjës  
odi, i  
këtij  
ën e  
9 të  
në  
bi  
in

kushtet laboratorike me mjete dhe teknik kriminalistike, u përpunuan me pluhur daktiloskopik dhe mbi sipërfaqen e tyre shihen gjurmë në formë njollash, por pa vija papilare, pra pa vlera identifikuese. Gjatë këqyrjes nuk u konstatua ndonjë gjurmë tjetër me vlera për hetimin.

24. Nga oficerët e policisë gjyqësore është bërë këqyrje e telefonit të sekuestruar shtetasit Muhamet Pavdeja dhe nuk u arrit të bëhej transkriptimi i bisedës së rregjistruar nga ky shtetas.

25. Në nenin 328/1/dh të K.Pr.Penale përcaktohet si shkak kur duhet vendosur pushimi i çështjes, kur del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai. Në rastin konkret, pasi janë kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme, nuk provohet të ekzistoj fakti penal apo të jetë kryer vepra penale nga personi nën hetim Liman Morina. Për rrjedhim ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë.

26. Për sa më sipër u arsyetua, gjykata vendosi të *pranoj* kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës “Për pushimin e çështjes penale nr.286, të vitit 2017”, sipas nenit 328/1/dh të K.Pr.Penale, ndjekja penale nuk duhet të vazhdoj.

**PER KETO ARSYE,**

Gjykata, bazuar ne nenet  
328/1/dh, 329, 329/a, 329/b e 379 të K.Pr.Penale,

**VENDOSI:**

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës.
- Pushimin e çështjes penale nr.286, datë rregjistrimi 24.06.2017, për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, për shkak se ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë, pasi nuk provohet që personi i dyshuar Liman Morina të ketë kryer veprën penale.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë kryer.
- Kundër këtij vendimi mund të bëj ankim prokuri në Gjykatën e Apelit Shkodër brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e shpalljes.
- U shpall në Kukës sot më datë 16.10.2017.

**Sekretare**

**Esmeralda GECA**

**Gjyqtare**

**Alma AHMETI**

31.10.2017

